



Prot. n. 114

Tiranë, më 5 tetor 2018

**Njoftim**

**Për punësimin e një specialisti/ eje të Zyrës së Këshillimit të Karrierës**

ZKM Universiteti Katolik “Zoja e këshillit të Mirë” kërkon të punësojë një specialist/e të Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Kohëzgjatja e kontratës do të jetë një vit, me kalimin e një periudhe prove prej tre muajsh. Angazhimi i punës është me kohë të plotë, duke filluar brenda muajit tetor 2018.

Kandidatët e interesuar duhet të zotërojnë:

1. Diplomë të nivelit të dytë në Shkenca Ekonomike/Politike/Sociale/ Marrëdhënie ndërkombëtare & Drejtësi, lëshuar nga Universiteti Katolik ZKM, nga Universitetet publike shqiptare, Universitetet jopublike shqiptare të akredituara, si nga ana institucionale ashtu edhe përsa i përket programit të studimit përkatës në kohën e lëshimit të diplomës nga institucioni, ose diplomë të lëshuar nga Universiteti i një vendi që i përket Bashkimit Europian;
2. Njohje shumë të mirë të gjuhës italiane, të konfirmuar me certifikatë ndërkombëtare, të paktën niveli B2, (nuk kërkohet certifikatë ndërkombëtare e gjuhës italiane për ata që kanë studiuar në universitetet italiane);
3. Njohje shumë të mirë të gjuhës angleze;
4. Njohje të mirë të programeve bazë të Microsoft Office Package (Word, Exel) dhe të burimeve të përbashkëta Web;
5. Aftësi të mira komunikuese;

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin e kërkuar në adresën e e-mailit [personale@fzkm.org](mailto:personale@fzkm.org) me objekt: **Pozicion pune – Specialiste/e Zyra e Këshillimit të Karrierës**, brenda datës **19 tetor 2018, ora 17.00**.

Dokumentacioni që duhet bashkëngjitur është:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar Administratorit të Universitetit (në gjuhën italiane);
2. Curriculum Vitae (në gjuhën italiane) me firmë;
3. Fotokopje të titullit të studimit dhe të listës së notave ;
4. Fotokopje të titujve të tjerë të mundshëm;
5. Fotokopje të një dokumenti identifikimi të vlefshëm në momentin e aplikimit.

Përzgjedhja e kandidatëve do të zhvillohet në datën e komunikuar më pas nga Zyra e Personelit të Fondacionit FZKM.

Administratore

Dott.ssa Evis Karandrea

